



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:150493

Datë: 07.05.2024

Numri i dokumentit: 05657653

PKR.nr.442/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i Trupit Gjykues Alban Ajvazi, si dhe me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Leutrim Hoti, në çështjen penale të pandehurve: N.L, O.B, SH.M, A.V dhe A.M, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 219 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.488/20 të datës 26.07.2021, konform dispozitave të nenit 287 par.1 të KPPRK-së dhe nenit 357 par.1, nënpar.1.3 të KPPRK-së, me datë 07.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.488/20 të datës 26.07.2021.

PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurve:

I. N.L, nga i ati B. dhe nëna A., e gjinisë H., i lindur më ..., në ..., Komuna e Podujeves, me vendbanim në ..., në fshatin Gllamnik, me nr. personal ..., i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesëm, me profesion berber, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

II. O.B, nga i ati A. dhe nëna H., e gjinisë D., i lindur më ..., në ..., Komuna Podujevë, ku edhe jeton në ..., me nr. personal ..., i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, pensioner, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

III. SH.M, nga i ati A. dhe nëna M.1, e gjinisë M.2, i lindur më ..., në ..., Komuna e Podujevës, me adresë banimi në ..., i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion shofer, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

IV. A.V, nga i ati Rr. dhe nëna A., e gjinisë S., i lindur më ..., në Podujevë, me vendbanim në ..., në ..., me nr. personal ..., i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, me profesion kamarier, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

V. A.M, nga i ati H. dhe nëna S., e gjinisë K., i lindur më ..., në Prishtinë, me vendbanim në ..., në ..., Komuna Podujevë, me nr. personal ..., i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, student, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

- Për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga aktakuza para fillimit të shqyrtimit gjyqësor.

Shpenzimet e procedurës penale mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë nën shenjën PP.I.nr.488/20 të datës 26.07.2021, kundër të pandehurve: N.L, O.B, SH.M, A.V, A.M, V.H dhe V.E, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 219 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata me aktvendimin nën shenjën PKR.nr.442/2021 të datës 06.02.2023 e ka veçuar procedurën për të pandehurin V.H, pasi që i njëjti sipas raportit të policisë gjendet jashtë shtetit, po ashtu me aktvendimi nën shenjën PKR.nr.442/21 të datës 13.02.2023 e ka veçuar procedurën për të pandehurin V.E, pasi që për të njëjtin prokurori i shtetit ka hequr dorë nga ndjekja penale dhe është hudhur aktakuza për të njëjtin me aktvendimin e datës 13.02.2023.

Gjykata me datën 01.02.2023 ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën të pandehurit: N.L, O.B, SH.M, A.V dhe A.M, ishin deklaruar të pa fajshëm për veprën penale e cila i vihet në barrë, me ç'rast gjykata i ka udhëzuar të njëjtit që brenda afatit prej 30 ditësh të paraqesin: çdo kundërshtim ndaj provave të cekura në aktakuzë dhe çdo kërkesë për hedhje të aktakuzës.

Të pandehurit nuk kanë paraqitur kërkesë për kundërshtim të provave dhe kërkesë për hedhje të aktakuzës.

Prokurori i shtetit Bashkim Zeqaj para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, me parashtresën e datës 03.05.2024, e ka njoftuar gjykatën se tërhiqet nga ndjekja penale, ndaj të pandehurve: N.L, O.B, SH.M, A.V dhe A.M, në drejtim të veprës penale në bashkëkryerje Falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 219 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për shkak se është krijuar praktika gjyqësore që në raste të njëjta penale aktakuza është refuzuar ose është marr aktgjykim lirues nga gjykata si dhe duke pas parasysh dashjen të pandehurve si element parësor i kryerjes së veprës penale.

Gjykata pas tërheqjes së prokurorit të shtetit nga ndjekja e penale për të pandehurit, analizimit të shkresave të lëndës dhe analizimit të bazës ligjore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, pasi që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me këtë dispozitivë ligjore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës, u mor në bazë të nenit 453 par.1 të KPRK-së.

Nga sa u tha më larte në bazë të nenit 287 par.1 të KPPRK-së dhe nenit 357 par.1, nënpar.1.3 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.442/21, datë 07.05.2024

Kryetari i Trupit Gjykes - Gjyqtari
Alban Ajvazi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa dhe mund të ushtrohet nga palët e pa kënaqura brenda pesë (5) ditëve, nga dita e pranimit, përmes kësaj gjykate, duke ju drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë.